

**Këshilli i Komunës së Kërçovës**

**Nr. 08-3349/2**

**28.12.2023**

**K ë r ç o v ë**

## **PROCESVERBAL**

**Nga seanca e 29-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 28.12.2023 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10 e 30 minuta.**

Seancën e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Kamerr Klosi, Drenuse Dalipi, Valbona Adili Emini, Agim Sadiku, Abdulla Sejdini, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Laze Jaqimoski, , Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Argjent Asani, Valentina Llazaroska, Ivanço Bozhinoski, Viktor Aleksoski, Ramazan Zulbeari, Fortesa Sejdini, Sibel Tufkegji dhe Migjen Zendeli.

Në seancë morrën pjesë edhe kryetari i Komunës së Kërçovës Fatmir Dehari, Aneta Nasteska –Sekretare e komunës, Burim Kadriu, Valdet Selimi, Darko Beleski, Emilija Petkoska, Igor Pejoski, Fisnik Fejza, Aleksandra Anaqioska, - përfaqses nga administrata komunale, drejtori i SHMK „Drita,, kryetari i bordit drejtues të SHMK „Mirko Mileski,, Kërçovë, kontabilistët e shkollave, drejtorët e :SHF „Sande Shtrjoski,, Kërçovë, SHF „Dr.Vladimir Polezhinoski,, Kërçovë, SHF „Rexho Rushit Zajazi,, Zajaz, SHF „Naim Frashëri, f.Jagolll Dolenc, SHF „Gjergj Kastrioti Skenderbeu,, f.Sërbicë, SHF „Faik Konica,, f.Greshnicë, ndihmës drejtori i SHF „ Milto Gurra,, f.Strellcë, UD i SHF „Kuzman Josifoski Pitu,, Kërçovë drejtoresha e Universitetit të Punës „Krste Misirkov,, Kërçovë, drejtori i IPK ÇF „Ollga Miceska,, dhe gazetarë nga Uskana.

Kryetari i këshillit - i përshëndeti të pranishmit dhe pyeti nëse dikush ka vërejtje për procesverbalin e seancës së 28-të të këshillit të mbajtur më 15.11.2023. Fjalën e morri:

Agim Sadiku - Ai i përshëndeti të pranishmit dhe njoftoi se është mirë që edhe kryetari i komunës është këtu që të dëgjojë edhe ai, se ashtu si më parë edhe tani ka pasur vërejtje se procesverbali nuk është përkthyer nga maqedonishtja në shqip ashtu siç duhet dhe se ka humbur kuptimi i asaj që është paraqitur në seancë.

Kryetari i këshillit - Ai bën me dije se disa herë është theksuar se përkthimi i procesverbalit dhe materialeve të tjera për këshillin duhet të jetë në rregull.

Kryetari i këshillit vendosi për miratim procesverbalin e seancës së 28-të të këshillit të mbajtur më 15.11.2023 me vërejtje, dhe i njejtë u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit për këtë seancë propozoi:

## **RENDI I DITËS**

1. Propozim Plani Zhvillimorë për vendosjen e fotovoltaikëve.
2. Propozim Buxheti në Komunën e Kërçovës për vitin 2024.
3. Propozim Vendimi për realizimin e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2024.
4. Miratimi i planit financiar për vitin 2024 të institucioneve në kompetencë të Komunës së Kërçovës.
  - SH.M.K “Drita” Kërçovë
  - SH.M.K “Mirko Mileski” Kërçovë
  - SH.F “Sande Shterjoski” Kërçovë
  - SH.F “D-r Vladimir Polezhinoski”
  - SH.F “Kuzman Josifoski Pitu”
  - SH.F “Rexho Rushit Zajazi” Zajas
  - SH.F “Naim Frashëri” f. Jagol Dolenci SH.F “GJ.K.Skenderbeu” Sërbicë
  - SH.F “Milto Gurra” Strellcë
  - SH.F “Faik Konica” Greshnicë
  - SH.F “Hirsto Uzunov” Dërgovë
  - I.P.K “Ollga Miceska” Kërçovë
  - I.K U.P “Krstë Misirkov” Kërçovë
5. Propozim Program në lëminë e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve për vitin 2024.
6. Propozim Programi në lëminë e sportit dhe rekreimit për vitin 2024.
7. Propozim Programi për aktivitetet në lëminë e menaxhimit në mjedisin jetësor në Komunën e Kërçovës për vitin 2024
8. Propozim Plan Operativ dhe program për dezinfektim , dezinfektim dhe deratizim.
9. Propozim plani dhe programi për zgjidhjen e problemit me kafshët endacake.
10. Propozim vendimi për dhënjen e pëlqimit për parashtrim të propozimit për eksproprijim.
11. Propozim Vendim për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal me Komunën e Makedonski Brod-it.
12. Propozim PLA për menaxhim me mbeturinat e forta.
13. Propozim Vendim për pranimin e donacionit të krevatëve spitalor.

14. Propozim Vendim për miratimin e Raportit për vlersimin e dëmit nga fatkeqësit tjera – zjarr nr.06- 2265/3 të dt.26.09.2023.

15. Propozim Vendim për miratimin e Raportit për vlersimin e dëmit nga fatkeqësit tjera – zjarr nr.06- 2525/3 të dt.03.10.2023.

16. Propozim Vendim për miratimin e Raportit për vlersimin e dëmit nga fatkeqësit tjera – zjarr nr.06- 2542/3 të dt.04.10.2023.

17. Propozim Vendim për miratimin e Raportit për vlersimin e dëmit nga fatkeqësit tjera – zjarr nr.06- 2853/3 të dt.13.11.2023.

18. Propozim Vendim për miratimin e Raportit për vlersimin e dëmit nga fatkeqësit tjera – zjarr nr.06- 2897/3 të dt.14.11.2023.

19. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të objektit pronë e Komunës së Kërçovës.

20. Të ndryshme.

**Kryetari i këshillit** bën me dije se për këtë seancë ka plotësim të rendit të ditës me një pikë shtesë: - Vendim për miratimin e propozimit të PDU-së për zonën industriale "Perëndim", NJU,,I,, Blloku,,IZ,, - pjesa 1, Komuna e Kërçovës, me Nr. tek. nr. 04-189/2022 nga dhjetori i vitit 2023, përgatitur nga „DPIGK,, „PARAMETAR DOOEL,, Shkup, përshkak s dje është marrë pëlqimi nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, dhe është dashur të miratohet nga këshilli në seancën e radhës, dhe seanca e radhës është sot.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim propozimin e rendit të ditës për seancën e sotme me propozim pikën shtesë dhe i njejt i miratua me 14 vota PËR, KUNDËR (asnjë), 8 vota PËRMBAJTUR.

Pikë e re do të jetë pika e katërt, ndërsa pika e katërt e rendit të ditës do të jetë pika e pesta, e pesta e gjashta, e gjashta e shtata, e shtata e teta, e teta e nënta, e nënta e dhjeta, e dhjeta e njëmbëdhjetë, e njëmbëdhjeta e dymbëdhjeta, e dymbëdhjeta e trembëdhjeta, e trembëdhjeta e katërbëdhjeta, e katërbëdhjeta e pesëmbëdhjeta, e pesëmbëdhjeta e gjashtëmbëdhjeta, e gjashtëmbëdhjeta e shtatëmbëdhjeta, e shtatëmbëdhjeta e tetëmbëdhjeta, e tetëmbëdhjeta e nëntëmbëdhjeta dhe e nëntëmbëdhjeta do të jetë pika e njëzetë e rendit të ditës.

**1. PIKA E PARË:** Propozim Planin Zhvillimorë për vendosjen e fotovoltaikëve.

**Burim Kadriu** – njofton se për territorin e Komunës së Kërçovës propozohet edhe një plan për fotovoltaikë për tre vitet e ardhshme, duke filluar nga viti 2024. Ai theksoi se projektet janë gati.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim Propozim Planin Zhvillimorë për vendosjen e fotovoltaikëve dhe i njejt i miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

## **2. PIKA E DYTË:** Propzim Buxheti në Komunën e Kërçovës për vitin 2024.

Kryetari i Komisionit për Financa dhe Buxhet Tefik Lutviu lexoi Raportin nga komisioni për seancën e mbajtur dhe pikat që ishin në kompetencë dhe që janë shqyrtuar nga ai komision.

**Agim Sadiku** – Informon se këtu ka një vërejtje në lidhje me propozuesin e buxhetit, gjegjësisht Kryetarin e Komunës, sepse neni 129 i Statutit të Komunës së Kërçovës nuk është respektuar, i cili i referohet afatit për dorëzimin e buxhetit te këshilltarët për shqyrtim. I njejtë është dashur t'u dorëzohet këshilltarëve nga mesi i muajit nëntor ndërsa u është dorëzuar më 11.12.2023. Ai theksoi se për buxhetin ka vërejtje teknike, sepse në të ka pasur shumë gabime, edhe në aspektin e viteve dhe nuk ka dashur ta miratojë si të tillë. Ai sugjeroi që meqenëse nuk është respektuar afati për dorëzimin dhe shqyrtimin e buxhetit nga këshilltarët, kjo pikë të mos diskutohet tani.

**Kryetari i Komunës** - Meqë është fundviti, i uroi mbarësi të gjithëve në familje, falënderoi për bashkëpunimin e të gjithë këshilltarëve dhe bashkëjetesën dhe theksoi se kështu duhet të vazhdojë për të mirën e Kërçovës. Ai theksoi se buxheti që kanë para tyre është përgatitur me mendimet e qytetarëve dhe me projekte dhe risi nga këtu dhe diaspora. Ai theksoi se buxheti për vitin 2024 është një miliard e njëqind e dymbëdhjetë milionë denarë ose 18 milionë e 94 mijë euro. Më pas ai shpjegoi buxhetin dhe të ardhurat dhe shpenzimet sipas zërave që janë paraqitur në grafa. Informoi se për atë se si shpenzoheshin paratë e komunës, do ta shohin në llogarinë përfundimtare. Ai theksoi se është planifikuar rikonstrukcioni i sallave, rrugëve lokale, rugicave, trotuareve, ndërtimi i parqeve rekreative, blerja e 4 automjeteve të transportit për transportin e nxënësve, për panele fotovoltaike dhe efizienzë elektrike, për mbjelljen e pemëve, për maratonë, për kulturë, për kanalizime dhe shumë projekte të tjera. Ai theksoi se duhet të respektohen vlerat tek të gjithë, pa dallim përkatësie dhe se njerëzimi jemi ne të gjithë dhe kjo është Kërçova.

**Laze Jaqimoski** - Ai e përshëndeti prezencën e Kryetarit të komunës dhe informon se fjalimi i kryetarit të komunës ishte kopi-past, siç ishte edhe buxheti i cili kishte shumë gabime teknike. Informon se në të kaluarën shumë herë keni bërë shkelje të ligjeve. Ai theksoi se këtë vit nuk ka pasur debat publik për buxhetin dhe nuk ka ditë nëse kryetari e ka mbajtur fletushkat e vitit të kaluar për të parë se çfarë është arritur nga ajo që është shkruar në të. Kryetari i komunës i ka dalluar qytetarët komunës pasi kishte pjesë të komunës që nuk ishin të rregulluara. Për fotovoltaikët ato gjithëmon ishin PËR . Ai pyet nëse do të vendosen fotovoltaikë në sallën e sportit në Ivanidol. Ai ka kërkuar raporte për ndërmarrjet që financohen dhe shumë raporte të tjera, por nuk ka marrë asnjë raport të tillë . Ai pyeti se kush e ka projektin e kanalizimit dhe a është duke u punëuar me të, dhe a është e mundur të dijë se çfarë është përbushur nga ajo që është kërkuar nga komuniteti lokal në komunë.

**Kryetari i Komunës**- Informon se Laze flet pa argumente dhe kjo flet për sinjeritetin e tij, përshkak se është punuar në projekte. Ai kërkoi të dalin së bashku

dhe të shohin se nëse po realizohet projekti i kanalizimit . Parqet janë realizuar,informon se nuk mund të ketë spital dhe çerdhe në Ivanidol sipas planeve urbanistike dhe këto kanë qenë kërkesa politike. Janë përmbushur kushtet për mbajtjen e mësimin në Gjimnazin dhe një milion janë investuar për ngrohje. Në shkollën „Kuzman Josifoski Pitumm është rregulluar parku, ndriçimi dhe terrenet sportive, por do të ndërtohet edhe një sallë sportive. Pas 1-2 muajsh, do të ketë ndërtesë të re administrative komunale, në të cilën janë investuar mbi një milion euro. Në kontiunitet po përgatiten projekte aty ku ka nevojë.

**Laze Jakimoski** - Ai informon se ka qenë i qartë dhe se të gjithë ato projekte janë mbështetur nga ana e këshillit dhe nuk kanë qenë kundër tyre. Buxheti është një plan dhe të gjitha mjetet që do të hyjnë duhet të zbatohen. Ai pyeti se kush e zbaton buxhetin.

**Kryetari i Komunës** - Qytetarët.

**Laze Jaqimoski** - Ai informon se nuk ka qenë kështu dhe se Kryetari flet sikurë ai e zbaton buxhetin.

**Kryetari i Komunës**-Unë jam kryetar, prandaj është ashtu. Gjithçka që bëhet është prioritet.

**Laze Jakimoski** - Ai pyeti pse nuk është ndërtuar spitali, por është ndërtuar objekti komunal.

**Kryetari i komunës** - Bën me dije se me decentralizim, nëse komunës i jepet autoriteti për të ndërtuar spitalin, ka premtuar se do ta ndërtojë për 3 vjet.

**Agim Sadiku**- Bën thirrje për më shumë seriozitet sa i përket buxhetit. Ai ishte gati për buxhetin, jo për planet. Ai bën me dije se llogaria e Gjimnazit ishte ende e bllokuar dhe në qoftë se ai do të ishte ministër do t'i hiqte kompetencat derisa të zgjidhej. Ishte e nevojshme të respektohej Statuti, por nuk ishte hera e parë që diskutohej buxheti dhe nuk respektohej Statuti, kjo nuk ishte çështje teknike, sepse humbi afatin prej 20 ditësh për dorëzimin e tij te këshilltarët. Ai ka theksuar se ka pasur gabime në planet zhvillimore nga seanca e kaluar dhe se ato nuk janë gabime teknike dhe është dashur të punohet seriozisht.

**Kryetari i Komunës** - Njofton se vërejtjet janë të korrekte, gjithashtu edhe përkthimi. Sa i përket buxhetit, ishte teknike përshkak se nuk është dorëzuar kohë, por qytetarët kanë mundur të paraqesin mendimin e tyre në mënyrë elektronike për buxhetin, nuk ka qenë “copy peste”.

**Abdulla Sejdi** - Ai përshëndeti të pranishmit dhe njoftoi se sa i përket kompetencës së komunës duhet të shihet se çfarë është realizuar nga projektet, gjegjësisht programet për vitin 2023, që të shkohet më tutje.

**Kryetari i Komunës** – bën të ditur se disa projekte në vitin 2023 janë realizuar, dhe disa janë në zhvillim e sipër. Ndërtimi i shumë rrugëve ka përfunduar, ndërtimi i gjimnazit, sallave sportive, teknologjia e re e mbeturinave është duke u zhvilluar, për

herë të parë është mbajtur maratonë në Kërçovë dhe shpreson se do të mbahet edhe në vitin 2024.

**Abdulla Sejdini** - Ai pyeti se deri ku është ndërtimi i Jançicës, a ka përfunduar ndërtimi i shkollës në Baçisht, a ka filluar ndërtimi i kanalizimit në f. Zajaz dhe kur do të përfundojë, a do të përfundojë ndërtimi në vitin 2024? Në lidhje me termocentralin Oslomej, i cili është ndotës i komunës qfarë po merret? Ende nuk ka përfunduar autostrada Kërçovë-Ohër, ka pasur rrëshqitje dhe përmytje mbi Krushinë, është folur për një zonë të lirë ekonomike, por nuk ka pasur asnjë investim ekonomik dhe shumë punë të tjera. Ai pyeti se cili është roli i kryetarit të komunës për përfundimin e këtyre projekteve.

**Kryetari i Komunës** - informon se salla sportive Jançica po ndërtohet dhe është drejt përfundimit, në Biçincë shkolla ka përfunduar, për kanalizimin dinamika e ndërtimit është 3 vjet, për autostradën publikisht ka reaguar që të përfundohet ndërtimi, për Krushinën gjithashtu ka reaguar publikisht në Qeveri dhe nëse nuk do të kishte realizim do të ndalohet. Për momentin, Oslomej punon me 60% përmes Fotovoltaikëve, ndërsa pritet që të lëshohen edhe më shumë, ndërsa për zonat falas ekonomike të gjithë presin dhe do të dëshironte që ajo të realizohej më shpejt nga ana e Ministrisë.

**Abdulla Sejdini** - Informon se në lidhje me projektet në territorin e Komunës së Kërçovës, gjithashtu duhej të ishte përmendur edhe pishina e notit që duhej të ishte gati deri në vitin 2018.

**Kryetari i Komunës**-Informon se pajtohet me këtë si edhe për autostradën dhe qendrën shëndetësore.

**Olgica Poposka**- Informon se ajo mund të propozojë dy gjëra ku komuna mund të marrë pjesë duke ndarë tokën shtetërore, domethënë: për ndërtimin e një shtëpie për të moshuarit dhe për ndërtimin e një tregu të gjelbërt të mbuluar të qytetit, me partneritet publiko-privat.

**Kryetari i Komunës** - bën të ditur se është diskutuar për këtë dhe gjithçka do të merret parasysh. Ai ka theksuar se pronësia e tregut është nën bashkësinë islame dhe do të diskutohet me ta për ta realizuar.

**Valentina Lazarevska** - informoi se komuna, si themeluese, duhet të investojë vazhdimisht në arsim dhe pyeti se kur do të fillojë ndërtimi i Sallës sportive në SHF „Kuzman Josifoski Pitu“, sepse kishin kaluar 3 vjet dhe ende nuk është ndërtuar salla sportive dhe nuk mund të mbaheshin orët sportive në shkollë. Ajo ka theksuar se terrenet sportive janë ndërtuar nga Agjencia për Sport dhe Rini.

**Kryetari i komunës** - njofton se komuna ka përgatitur projektin për terrenet sportive dhe ka aplikuar. Është përgatitur gjithashtu edhe projekti për sallën sportive dhe është aplikuar në Bankën Botërore. Ndërtimi do të nisë në vitin 2024.

**Laze Jakimoski**- Infomon se për sallën kanë biseduar me Eminin .Ai u kërkoi të pajtoheshin me të dhe të thoshin të njëjtën gjë, jo ndryshe. Asgjë nuk kishte filluar ende atje.

**Kryetari i komunës** – bën të ditur se për shkak të problemeve administrative me tokën, ende nuk ka filluar.

**Laze Jakimoski**- informon se Emini ju tha që ato probleme janë zgjidhur, por për 2 vjet asgjë nuk ka ndodhur, ai kërkoi që të ndihmohet dhe ajo të realizohet.

**Ivanço Bozhinoski** - Informon se buxheti duhet të jetë kornizë për realizimin e projekteve. Ai theksoi se problemet administrative me tokën në lidhje me ndërtimin e sallës së sportit në SHF „Kuzman Josifoski Pitu,, janë zgjidhur dhe se ajo duhet të përfundojë deri në fund të vitit 2024. Sa i përket ndërtimit të rrugëve, ai kërkoi që të mos ketë populizëm, sepse është ndërtuar vetëm në pjesët ku jetonte popullsia shqiptare, dhe jo aty ku jeton popullsia maqedonase, nuk ishte kështu dhe janë bërë përparësi për vendet ku do të ndërtoheshin. Ai bëri thirrje që të miratohet buxheti që të punohet.

**Laze Jakimoski** - Ai informon se deri më tani nuk ka pasur asnjë shembull të këtij rasti dhe se Konkluzionet janë miratuar në këshill, por ato nuk u zbatuan.

**Kryetari i këshillit** dha një pushim prej 5 minutash. Pas pushimit seanca vazhdoi.

**Igor Stojanoski**- Informon se do ta përkrah buxhetin dhe falënderoi kryetarin e komunës që personalisht është angazhuar për rrugën afër Rbetinos. Ai theksoi se kryetari i Komunës kishte bërë shumë për qytetin dhe kishte akoma projekte me të cilat do të ndërtohet. Ai thekson se ka një vërejtje për Kryetarin e komunës për pankartat për mirëseardhjen e mërgimtarëve që ishin vendosur vetëm në gjuhën shqipe. Në seancën e 23-të të këshillit është vendosur që ato të vendosen në gjuhën maqedonase dhe turke, por kjo nuk është respektuar.

**Kryetari i komunës** - bën të ditur se ka dashur që administrata komunale t'i dëgjojë ato kritika dhe se ashtu duhet bërë. Ai theksoi se administrata duhet ta bënin këtë dhe ti vendosnin pankartat në maqedonisht dhe turqisht.

**Kryetari i Këshillit** informoi se në atë seancë ka qenë i pranishëm edhe Sekretari i Komunës dhe u mor një vendim që pankartat për mirëpritjen e mërgimtarëve duhet të përgatiteshin dhe të vendosen në tre gjuhë.

**Valbona Adili Emini** -informata që në lidhje me mbrojtjen e qenve, ajo nuk ka dëgjuar asgjë nga kryetari i komunës të thotë dicka në lidhje me të, pasi që ajo është kafshuar nga një qen dhe gjithashtu për ndotjen, pasi që ne duhet të ishim kujdesur dhe të kontribuojmë për këtë dhe për të mirën e qytetarëve.

**Kryetari i komunës**- informoi se në buxhet janë siguruar mjete për trajtimin e qenve dhe ato janë trajtuar deri më tani, ai u kërkoi të gjithëve të ndihmojnë në këtë drejtim. Ai theksoi se qentë silleshin në qytet nga diku. Për të janë bërë shumë projekte dhe ende po punohet në këtë drejtim.

**Agim Sadiku**- Bën me dije se sa i përket buxhetit, kryetari nuk i ka marrë parasyshë sugjerimet e tij për afatet. Ai theksoi se ende nuk ka decentralizim fiskal, por duhet projektuar dhe investuar për zhvillimin e mëtutjeshëm të komunës. Ai informon se nuk pajtohet për buxhetin ku 42%, 48%, etj. ishin më mbrapa në buxhetin bazë. Ai shpreson që kryetari i komunës do të jetë më shpesh i pranishëm në seancat gjatë vitit 2024. Kryetari i komunës ka dhënë subvencione për bizneset e vogla. Ai thekson se disa herë ka kërkuar që të përgatitet një raport se deri ku janë me realizimin e subvencioneve. Buxheti duhej të rritej, por ishte pothuajse njësoj si vitin e kaluar dhe kjo e bëri të mendonte se kishte klientelizëm. Ai kërkoi pagesë më të lartë të taksave dhe të dorëzohet një listë për të parë se kush ka marrë subvencione dhe të shihet pagesa, por një listë e tillë nuk është dorëzuar. Ai ka theksuar se nuk është i kënaqur me pagesën e taksave dhe ka kërkuar që të punohet më shumë për të.

**Kryetari i komunës** - informon se strategjia për subvencionimin e ndërmarrjeve të vogla ka qenë e mirë, sepse për 5 vjet janë hapur 60 ndërmarrje të reja, 50% e të cilave funksionojnë. Ka pasur një imput në këtë dhe subvencionet për ta duhet të rriten.

**Daniela Poposka**- Informon se për vendimin për vendosjen e pankartave në maqedonisht, turqisht dhe shqip, kryetari i Komunës duhet t'i ketë parë dhe tani fajin ia kalon administratës komunale. Ajo ka theksuar se kryetari i komunës ka qenë i obliguar që t'ia tregojë detyrat e punës administratës dhe nëse ajo nuk i respekton të fillojë procedura disiplinore ndaj punonjësve. Ajo sugjeroi që të respektohet në të ardhmen.

**Kryetari i këshillit** - Ai informon se është njoftuar se dje janë dorëzuar amendamentet lidhur me buxhetin të paraqitura nga këshilltari Mihajlo Daniloski. Dhe u kalua në shqyrtimin e tyre.

### **Amendamenti 1**

**Mihajlo Daniloski** - Informon se me amendamentin propozohet të sigurohen mjete në shumë prej 500.000 den. për zhvillimin e turizmit në qytet dhe vendbanimet përreth.

**Burim Kadriu** - Ai ka propozuar që të mos pranohet amendamenti, sepse janë paraparë mjete për të.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe i njëjti nuk u miratua me 6 vota PËR, 10 vota KUNDËR. 3 vota PËRMBAJTUR.

### **Amendamenti 2**

**Mihajlo Daniloski** - Informon se me këtë amendament propozohet të sigurohen mjete në shumë prej 500.000 den. më shumë për rindërtimin e shkollave fillore në vendbanimet përreth.



**Burim Kadriu** - Ai ka propozuar që të mos miratohet amendamenti, pasi që janë paraparë mjete për të.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe i njejt i nuk u miratua me 7 vota PËR. 10 vota KUNDËR. 3 vota PËRMBAJTUR.

### **Amendamenti 3**

**Mihajlo Daniloski** - Ai informon se propozon që të sigurohen mjete në vlerë prej 3.000.000 denarë më shumë me shkurtime nga nënzëri për blerje të pajisjeve informative dhe video-pajisje dhe të destinohen për rindërtimin e shkollave fillore në vendbanimet përreth.

**Burim Kadriu** - Ai sugjeroi që të mos pranohet amendamenti, sepse mjetet për të ishin paraparë në një program përkatës.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe i njejt i nuk u miratua me 6 vota PËR, 13 vota KUNDËR. 4 vota PËRMBAJTUR.

### **Amendamenti 4**

**Mihajlo Daniloski** - Informon se propozon të sigurohen mjete në shumë prej 1.300.000 den. më shumë për shërbimet veterinarë, pra zgjidhjen e problemit të qenve endacakë në qytet.

**Burim Kadriu**- Propozohet të mos pranohet propozimi, sepse ato mjete janë të nevojshme për sinjalistikën në komunikacion.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe i njejt i nuk u miratua me 8 vota PËR. 12 vota KUNDËR. 2 vota PËRMBAJTUR.

### **Amendamenti 5**

**Mihajlo Daniloski**- Informon se propozon që të sigurohen mjete në vlerë prej 3.000.000 më shumë për blerjen e automjetit për transportin e nxënësve në SHf “Hristo Uzunov” në Drugovë.

**Burim Kadriu**-Bën me dije se mjetet nga Byroja Zhvillimore për blerjen e automjetit janë siguruar në program përkatës. Ai propozoi që të mos pranohet amendamenti.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe i njejt i nuk u miratua me 7 vota PËR, 13 vota KUNDËR, 3 vota PËRMBAJTUR.

### **Amendamenti 6**

**Mihajlo Daniloski**- Informon se propozon të sigurohen mjete në shumë prej 900.000 den. më shumë për zgjidhjen e problemit me deponitë në të gjithë qytetin dhe vendbanimet përreth.

**Burim Kadriu** – Informon se do të nevojiten edhe më shumë mjete në Programin e Urbanizmit, e jo shkurtime. Ai propozoi që të mos pranohet amendamenti.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe u njehti nuk u miratua me 8 vota PËR, 13 vota KUNDËR. 2 vota PËRMBAJTUR.

**Amendamenti 7** – Parashtruar nga Grupi i këshilltarëve të VMRO-DPMNE-së **Valentina Lazarevsaka** - Informon se për modernizimin e mësimdhënies me mjete të reja mësimore dhe edukative (tabela interaktive, mobilimi i kabineteve...) propozohet të sigurohen mjete prej 800.000 denarë.

**Burim Kadriu**- Informon se ato mjete nevojiten dhe nuk duhet të zvogëlohen për shkak të funksionimit të administratës komunale dhe shërbimeve kontraktuale dhe vlera që është kërkuar nuk korrespondon dhe shkollat mund t'i sigurojnë ato mjete nga bllok-dotacionet.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim amendamentin e propozuar dhe i njehti nuk u miratua me 8 vota PËR. 12 vota KUNDËR. 3 vota PËRMBAJTUR.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim Propozim-buxhetin e Komunës së Kërçovës për vitin 2024 dhe i njehti u miratua me 15 vota PËR, KUNDËR (asnjë). 8 vota PËRMBAJTUR.

**Kalohet në:**

**3. PIKA E TRETË:** Propozim Vendimi për realizimin e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2024.

**Agim Sadiku** - Njofton se në Vendim ka pasur gabim teknik dhe në vend të 01.01.2023. duhet të ishte 01.01.2024 dhe propozoi që të ndryshohet.

**Burim Kadriu**- Bën me dije se ai Vendim është po aq i rëndësishëm sa buxheti dhe pa të nuk do të mund të realizohej buxheti.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim Propozim Vendimi për realizimin e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2024 me ndryshimin dhe i njehti u miratua me 15 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 8 vota PËRMBAJTUR.

**Kryetari i komunës**- bën të ditur se shpeshherë nuk ka ardhur në seancë, sepse nuk ka dashur të ndikojë në punën e këshillit, por në seancë mund të vijë gjithmonë kur të thërritet nga cilido.

**Kryetari i këshillit** dha një pushim prej 5 minutash. Pas pushimit seanca vazhdoi. Kaluam te pika plotësuese e rendit të ditës:

**4. PIKA E KATËRT:** Propozim-Vendim për miratimin e propozimit të PDU-së për zonën industriale "Perëndim", NJU,,I,, Blloku,,IZ,, - pjesa 1, Komuna e Kërçovës, me Nr. tek. nr. 04-189/2022 nga dhjetori i vitit 2023, për gatitur nga „DPIGK,, „PARAMETAR DOOEL,, Shkup

**Fisnik Fejza** - Ai e shpjegoi Vendimin në mënyrë të detajuar dhe ka bërë të ditur se në paraqitjen grafike ka pasur disa parcela për qëllime. Gjatë përgatitjes së planit urbanistik, përparësi kanë pasur objektet që janë kërkuar me fletë anketime. Nuk ka pasur ndryshime në qëllime. Vendimi është miratuar dhe nga Ministria e Transporteve dhe tani është dashur që të silllet Vendim nga këshill dhe për këtë arsye është futur në rend dite.

**Kryetari i këshillit** e vendosi për miratim Propozim-Vendim për miratimin e propozimit të PDU-së për zonën industriale "Perëndim", NJU,,I,, Blloku,,IZ,, - pjesa 1, Komuna e Kërçovës, me Nr. tek. nr. 04-189/2022 nga dhjetori i vitit 2023, përgatitur nga „DPIGK,, „PARAMETAR DOOEL,, Shkup dhe i njejtë është miratuar me 16 vota PËR. KUNDËR (asnjë). 6 vota PËRMBAJTUR.

**5. PIKA E PESTË:** Miratimi i planit financiar për vitin 2024 të institucioneve në kompetencë të Komunës së Kërçovës.

• SH.M.K “Drita” Kërçovë • SH.M.K “Mirko Mileski” Kërçovë • SH.F “Sande Shterjoski” Kërçovë • SH.F “D-r Vladimir Polezhinoski” • SH.F “Kuzman Josifoski Pitu” • SH.F “Rexho Rushit Zajazi” Zajas • SH.F “Naim Frashëri” f. Jagol Dolenci • SH.F “GJ.K.Skenderbeu” Sërbicë • SH.F “Milto Gurra” Strellcë • SH.F “Faik Konica” Greshnicë • SH.F “Hirsto Uzunov” Dërgovë • I.P.K “Ollga Miceska” Kërçovë • I.K U.P “Krstë Misirkov” Kërçovë

**Viktor Aleksoski**-Kërkoj që të gjitha planet financiare të votohen në paketë, përshkak se të gjitha i kanë shqyrtuar.

**Abdulla Sejdi** - Ai ka kërkuar që të gjitha planet të shqyrtohen dhe të votohen individualisht, përshkak se kanë buxhete të veçanta.

Vazhdohet me shqyrtimin dhe votimin individual të planeve financiare.

